

Nr.regj. 18232/2012

218/1000
02
03 08 2012

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË, duke vendosur në procedurën për kundërvajtje kundër të pandehurit Ismajl Smakiqi nga Mitrovica, për kundërvajtje nga neni 8 lidhur me nenin 5.1 dhe 6.2 të ndëshkuar me nenin 17 parag.1.1 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publik, Nr.04/L-050, në bazë të nenit 73,74,195,199 të Ligjit mbi Kundërvajtjet GZK 23/79, me datë **01.08.2012** merr këtë:

A K T V E N D I M

I PANDEHURI: Smajl Bajram Smakiqi, i lindur më 21.05.1957 në Mitrovicë, ku edhe tani jeton, me vendbanim në rrugën "Agim Hajrizi" 8/85, Drejtor i Akademisë së Kosovës për Siguri Publike në Ministrinë e Punëve të Brendshme, me shkollim superior, i martuar, babë i dy fëmijëve, i gjendjes së mirë ekonomike,

Ë s h t ë P ë r g j e g j ë s

Sepse, si Zyrtar i Lartë Publik, në pozitë të Drejtor i Akademisë së Kosovës për Siguri Publike në Ministrinë e Punëve të Brendshme, nuk e ka bërë deklarimin e rregullt të gjendjes së pasurisë në Agjencinë Kundër Korrupsionit, brenda afatit ligjor deri më 31.03.2012,
- me çka ka kryer kundërvajtje nga neni 8 lidhur me nenin 5.1 dhe 6.2 të ndëshkuar me nenin 17 parag.1.1 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publik, andaj të pandehurit për këtë kundërvajtje i shqiptohet,

D Ë N I M I

Me gjobë në shumë prej 2000 € (Dymijë Euro) të cilën shumë i pandehuri është i obliguar ta paguaj në afat prej 15 ditësh, pasi që ky aktvendim të merr formë e prerë, në llogarinë e të hyrave gjyqësore të KGJK-së No.1000 4300 7000 0518. Paga bëhet në ndonjërin agjenci për mbledhjen e të hyrave-bankë, përmes urdhërpagesës së plotësuar nga Gjykata. Nëse gjobën e shqiptuar nuk e paguan në afatin e dhënë, e njëjta do të zëvendësohet me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 30 ditësh, duke llogaritur nga 15 Euro për një ditë burgimi. Shpenzime të procedurës nuk ka pasur, kurse në emër të paushallit gjyqësor i pandehuri është i obliguar të paguaj shumë prej **5 Euro** në shërbimin e arkës së gjykatës. Nga një kopje e këtij aktvendimi i dërgohet parashtruesit të kërkesës dhe të pandehurit.

A r s y e t i m

Agjencia Kundër Korrupsionit në Prishtinë, i parashtrori kësaj gjykate Kërkesën 01-1822/2012 me datë 22.05.2012 për fillimin e procedurës kundërvajtëse ndaj të pandehurit të lartshënuar për kundërvajtjen e precizuar si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Në bazë të kërkesës së parashtruar, gjyqtarja filloi procedurën kundërvajtëse, mori në pyetje të pandehurin i cili në mbrojtjen e vet deklaroi se e pranon kundërvajtjen e cila i vihet në barrë duke shtuar se detyrën e drejtorit që e mban aktualisht e kishte marrë në muajin tetor të vitit 2011 me ç'rast kishte bërë deklarimin pasurisë me marrjen e detyrës, por meqë ky deklarim ishte publikuar në ueb faqe të Agjencisë në vitin 2012, kishte menduar se ai deklarim është i mjaftueshëm për vitin 2012. Në vazhdim thekson se me kohë ka qenë i informuar nga zyrtari i personelit, por ka qenë i bindur se ai veç e ka përmbushur obligimin, më vonë ka kuptuar se ligjërisht deklarimi i rregullt vjetor është i veçantë, andaj me vonësë, saktësisht me datë 21.05.2012 e kishte deklaruar pasurinë. I

pandehuri shton se nuk ka pasur asnjë arsye për mosdeklarim të rregullt të pasurisë, por ka pasur bindje të gabuar, e paraprakisht nuk ka mbajtur pozitë të zyrtarit të lartë publik me obligim për deklarim të pasurisë.

Nga të dhënat në kërkesë, vlerësimi i deklaratës së të pandehurit dhe shqyrtimi i shkresave të tjera të lëndës, administrimi i secilës veç e veç dhe të gjitha së bashku, gjyqtarja në masë të mjaftueshme vërtetoi gjendjen e plotë dhe të drejtë faktike, ekzistimin e veprës kundërvajtëse dhe përgjegjësisë së të pandehurit për këtë kundërvajtje, meqë i njëjti nuk e ka rrespektuar afatin e dhënë ligjor për deklarim të rregullt të pasurisë, thjeshtë çështjen e kishte neglizhuar derisa ka kuptuar seriozitetin dhe pasojën e mosdeklarimit, andaj për kundërvajtjen e kryer i shqiptoi dënimin e paraparë ligjor.

Gjatë shqiptimit të dënimit gjyqtarja pati parasysh rrethanat nga neni 7 i LK në të cilat është kryer kundërvajtja dhe sipas peshës së kundërvajtjes e shkallës së përgjegjësisë së pandehurit, e duke vlerësuar edhe personalitetin e të pandehurit e gjendjen e tij materiale, të njëjtin e dënoi me dënimin me gjobë të precizuar si në dispozitiv të këtij aktvendimi, me bindje se edhe me një gjobë të tillë do të arrihet qëllimi i ndëshkimit dhe se i pandehuri në të ardhmen do të shmanget nga kryerja e ndonjë kundërvajtjeje të natyrës së tillë apo të ngjashme.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

U VENDOS NË GJYKATËN KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË
Nr.regj.18232/2012, datë 01.08.2012

Gjyqtarja
Suzana Çerkini



KËSHILLA JURIDIKE: Këndër i këtij aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 8 ditësh Gjykatës së Lartë për Kundërvajtje në Prishtinë, nga data e pranimit të njëjtit nëpërmjet kësaj gjykate, pa taksa.